



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Nr. 4831/1 prot.

Tiranë, më 12. 11. 2025

Lënda: Shpallje për subjektin "FLORES" SH.P.K

SUBJEKTIT "FLORES" SH.P.K

Adresë: Lagjia nr.13, Plazh, objekt me nr.pasurie 58/86, Durrës

Durrës

Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Tiranë Rajoni I, ka kryer inspektim në subjektin "FLORES" sh.p.k me Nipt M41828501N dhe adresë Lagjia nr.13, Plazh, objekt me nr.pasurie 58/86, Durrës. Gjatë procesit të inspektimit bazuar në nenin 42 të ligjit nr.99, datë 12.09.2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", është mbajtur procesverbali i inspektimit me Nr.ISHPSHSH-TR-2025-004792-SHKRESORE-3, datë 30.10.2025.

Në zbatim të procedurave që parashikon ligji nr.99, datë 12.09.2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", njoftimi i subjektit për procesverbalin e inspektimit nuk është bërë i mundur të kryhet nëpërmjet dorëzimit personal dhe me postë në adresën ku subjekti ushtron aktivitet, adresa e deklaruar në ekstraktin e QKB-së. Objekti postar është kthyer mbrapsht me shënimin "Larguar".

Bazuar në nenin 162 të ligjit nr. 44/2015 Kodi Procedurës Administrative, Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH-së Tiranë Rajoni I ka vendosur, njoftimin e subjektit "FLORES" sh.p.k me Nipt M41828501N dhe adresë Lagjia nr.13, Plazh, objekt me nr.pasurie 58/86, Durrës, për njohjen me procesverbalin e inspektimit me anë të shpalljes dhe njoftimit duke e afishuar në zyrat e ISHPSHSH-së, në adresën e subjektit ku është ushtruar inspektim, QKB dhe në mjediset e Drejtorisë Qëndrore të ISHPSHSH-së dhe në faqen zyrtare të web. Në zbatim të pikës 3 të nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 Kodit të Procedurës Administrative njoftimi do të vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Për faktet dhe rrethanat e paraqitura në procesverbalin e inspektimit subjekti "FLORES" sh.p.k, mund të paraqes shjegimet apo kontestimet e tij me shkrim ose gojë, pranë inspektoratit shtetëror, brenda 8 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit.

Për njohjen me përmbajtjen e plotë të Procesverbalit të Inspektimit dhe marrjen e kopjes së tij mund të paraqiteni pranë Drejtorisë Rajonale të ISHPSHSH-së Tiranë Rajoni I, adresë Rr. "Sheh Ahmet Pazarit", nr.10, Tiranë.

Ky njoftim shpallet sot më datë 12.11.2025 dhe qëndron i afishuar deri në datë 24.11.2025.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYEINSPEKTORI RAJONAL

Ardit Shabanaj

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
PËRGJEGJËS SEKTORI
ARMANDO LOGA**

Rruga "Sheh Ahmet Pazarit", nr.10, Tiranë

Telefon: 2 302 017